

Gjyqtarët e Gjykatave të Krimeve të Rënda japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake: Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) prezanton të dhënat në Raportin Vjetor për vitin 2018

- *Emërimi i përkohshëm i gjyqtarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda në Gjykatat e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar: Dhënia e pëlqimit për kufizimin e privatësisë dhe dorëzimi i deklaratave pranë KLGJ-së*

Një nga detyrat më të rëndësishme të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) pas [konstituimit](#) të këtij organi gjatë muajit dhjetor 2018, ishte emërimi i përkohshëm i gjyqtarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda në Gjykatat e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Siç është [trajtuar](#) edhe më parë, ndryshimet kushtetuese të miratuara në kuadër të reformës në sistemin e drejtësisë parashikuan për Gjykatat e Krimeve të Rënda transformimin e tyre në Gjykata të Posaçme.

Ndër hapat e parë në drejtim të realizimit të këtij procesi ishte emërimi i përkohshëm i gjyqtarëve të Krimeve të Rënda në nivelin përkatës në Gjykatat e Posaçme, i cili realizohet pasi këto të fundit së bashku me familjarët e afërt të tyre të japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake. Këshilli i Lartë Gjyqësor shërbën si një organ emërtese për dorëzimin e deklaratave të gjyqtarëve dhe familjarëve të tyre të afërt.

Emërimi i përkohshëm i gjyqtarëve të Krimeve të Rënda, sipas afateve ligjore **parashikohej të përfundonte brenda dy javëve nga krijimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor**. Për këtë arsye ky organ nisi në fund të [muajit dhjetor 2018](#) procedurat për caktimin e përkohshëm të gjyqtarëve të Krimeve të Rënda pranë Gjykatave të Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, me qëllim për t'i hapur rrugë krijimit të institucioneve kryesore për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Megjithëse gjatë kësaj periudhe **nuk ka patur një prononcim zyrtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor mbi këtë proces**, fakt i cili është [risjellë disa herë në vëmendje](#) të opinionit publik, në Raportin Vjetor ["Mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2018"](#) që ky institucion i ka dërguar Kuvendit të Shqipërisë në fillim të muajit [maj 2019](#), janë prezantuar të dhënat e

Ky numër i SPAK Info, i cili mbulon zhvillimet më të fundit, i dedikohet ecurisë së ngritjes së Gjykatave të Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar si edhe emërimin të gjyqtarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda në Gjykatat e Posaçme. Të dhënat i janë referuar Raportit Vjetor të KLGJ-së për vitin 2018.

Për shumë informacion mbi zbatimin e hapave ligjorë në drejtim të ngritjes së Gjykatave të Posaçme dhe SPAK mund të lexoni Buletinet 3-mujore SPAK Monitor të publikuara në faqen e CSDG: www.csdgalbania.org

plota mbi këtë proces, specifkisht mbi numrin e gjyqtarëve, të cilët kanë pranuar të nënshkruajnë deklaratat respektive për kufizimin e privatësisë.


Aktualisht, bazuar në këtë raport, të gjithë gjyqtarët (14) e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda¹ kanë pranuar të japin pëlqimin për kufizimin e privatësisë, ndërkohë 8 nga 11 gjyqtarë të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda kanë pranuar të japin pëlqimin dhe dorëzojnë deklaratat respektive. Referuar numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve në Gjykatat e Krimeve të Rënda (25 në total), numri i atyre, të cilët kanë pranuar kushtet mbi kufizimin e privatësisë, duke përfshirë këtu edhe familjarët e afërt të tyre është relativisht i konsiderueshëm. Megjithatë emërimi përfundimtar i tyre në Gjykatat KKKO do të përcaktohet nga vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nëpërmjet konfirmimit në detyrë.

Procesi i rivlerësimit thelbësor për konfirmimin e gjyqtarëve në Gjykatat e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar: 24% e gjyqtarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda i janë nënshtruar vetting-ut

- *Ecuria e deritanishme e procesit të rivlerësimit për gjyqtarët e Gjykatave të Krimeve të Rënda: Ritmet e procesit ende të ngadalta, vetëm për 6 nga 25 gjyqtarë KPK ka përfunduar procesin e rivlerësimit*

Konfirmimi në detyrë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) apo Kolegji i Posaçëm i Apelimit (në rast ankimit të vendimeve të KPK) janë të detyrueshme për konfirmimin përfundimtar të gjyqtarëve në Gjykatat e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Megjithëse KPK pas rreth 9 muajsh, që nga muaji [korrik 2018](#) zhvilloi në fillim të [muajit prill](#) seanca dëgjimore me 2 gjyqtarë të Gjykatave të Krimeve të Rënda, ritmet e këtij procesi janë shumë të ngadalta.

Nëpërmjet shorteve të hedhura në muajt [maj 2018](#) dhe [janar 2019](#), KPK ka njoftuar për fillimin e procedurave të rivlerësimit për të gjithë gjyqtarët e Gjykatave të Krimeve të Rënda. Aktualisht, për vetëm **6 gjyqtarë të Krimeve të Rënda ka përfunduar procesi i rivlerësimit**, nga të cilët 1 është shkarkuar dhe 1 tjetër është ende në pritje të vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (KPA).



¹ Nga 15 gjyqtarë në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, numri aktual është 14, pasi gjyqtari Dritan Hallunaj është zgjedhur në dhjetor 2018 anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Aktualisht, Gjykatat e Krimeve të Rënda vazhdojnë të ushtrojnë kompetencat e parashikuara në legjislacionin në fuqi [deri në ngritjen dhe funksionimin](#) e Gjykatave të Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Rezultatet e vetting-ut, ritmet e deritanishme të këtij procesi apo numri i mundshëm i ankimimeve për këto gjyqtarë mund të sjellin shtyrje dhe vonesa të mëtejshme lidhur me emërimin e tyre dhe fillimin e ushtrimit të veprimtarisë së Gjykatave KKKO, të cilat janë parashikuar të përbëhen nga 16 gjyqtarë në Shkallën e Parë dhe 11 gjyqtarë në Gjykatën e Apelit. Ecuria e suksesshme dhe rezultat pozitiv të kësaj faze do të shmangnin vonesa të panevojshme dhe në dëm të procesit të ngritjes së këtyre organeve me rol thelbësor në gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar.

- *Ngritja e strukturave të specializuara për të vijuar bashkëpunimin me institucionet e rivlerësimit kalimtar: Ngritja e Komisionit të Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe të subjekteve të tjera të rivlerësimit*

Megjithëse emërimi i gjyqtarëve në Gjykatat e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar përbën një fazë, ecuria e së cilës do të përcaktojë ngritjen e këtyre organeve, avancimi i procesit të rivlerësimit në tërësi për gjyqtarët është gjithashtu një nga prioritetet e të gjithë procesit. Koordinimi me struktura të specializuara për të ndihmuar në përshejtimin e vetting-ut është i rëndësishëm gjithashtu edhe për aplikime të tjera të mundshme, të cilat mund të vinë nga gjyqtarë të cilët nuk i përkasin Gjykatave të Krimeve të Rënda. Në varësi të numrit të konfirmimeve dhe vendimeve të apeluara, ky proces do jetë po kaq thelbësor për të krijuar mundësinë e plotësimin të numrit të vendeve të parashikuara në Gjykatat e Posaçme me qëllimin ngritjen dhe funksionimin e tyre.

Në këtë dretjim, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka krijuar [Komisionin e Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe të subjekteve të tjera të rivlerësimit](#). Ky komision koordinon punën me institucionet e rivlerësimit si dhe Këshillin e Lartë Gjyqësor për përmbushjen e detyrave gjatë këtij procesi. Gjithashtu KLGJ ka miratuar [Rregulloren "Mbi organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në Kuadër të Procesit të Rivlerësimit Kalimtar të Gjyqtarëve"](#), në të cilën përcaktohen rregulla të hollësishme për mirëfunksionimin e këtij procesi.

Vlerësimi i aftësive etike dhe profesionale të gjyqtarëve ka qenë një nga objektivat kryesore të vitit 2018 edhe për veprimtarinë e ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë (ish-KLD), organ i cili në kuadër të rivlerësimit kalimtar ka dërguar pranë KPK në total 111 raporte të hollësishme dhe të arsyetuara për 111 subjekte rivlerësimi.²

Pas krijimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vazhduar vlerësimin e aftësive profesionale për gjyqtarët dhe ka hartuar raportet e hollësishme dhe të arsyetuara, të cilat ka qenë 41 për 41 subjekte rivlerësimi. Siç evidentohet edhe në [Raportin Vjetor për vitin 2018](#), pavarësisht punës voluminoze apo mangësive në dokumentacion, të cilat shpesh kanë sjellë vonesa në hartimin e raporteve të hollësishme, ecuria e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve do të jetë një nga qëllimet kryesore të punës së KLGJ-së për vitin 2019.

² Të dhënat i referohen Raportin Vjetor "Mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2018"

Përmbushja e hapave të tjerë ligjorë në drejtim të ngritjes së Gjykatave të Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar: Verifikimi i kushteve ligjore për Kancelarët dhe koordinimi me Këshillin e Lartë të Prokurorisë (KLP)

- *Verifikimi i kushteve ligjore për kancelarët në detyrë: Emërimi i kancelarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda në Gjykatat e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar*

Ngritja, por në mënyrë të veçantë funksionimi i Gjykatave të Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, do të bazohet në përmbushjen e një sërë hapash ligjorë dhe administrativë. Përveç emërimit të gjyqtarëve në këto Gjykata, po kaq i rëndësishëm është edhe emërimi i kancelarëve, të cilët janë nëpunësit më të lartë të Gjykatës, me një rol të rëndësishëm gjatë procesit të rekrutimit të nëpunësve dhe stafit administrativ në këto Gjykata duke përfshirë plotësimin e kushteve të sigurisë të parashikuara sipas legjislacionit.

Sikurse edhe në rastin e gjyqtarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda, edhe për kancelarët në detyrë në Gjykatat e Krimeve të Rënda është parashikuar vijimësia në detyrë, vetëm nëse këto të fundit japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe telekomunikimeve vetjake. Në këtë mënyrë, KLGJ brenda gjashtë muajve nga krijimi duhet të verifikojë plotësimin e kushteve dhe kriterëve ligjorë të pozicionit të kancelarit, si dhe të bëjë verifikimin e figurës dhe të pasurisë së kancelarëve në detyrë. Nëse kancelari në detyrë nuk e kalon me sukses verifikimin e pasurisë, të figurës, kushteve dhe kriterëve ligjorë, sipas ligjit, marrëdhëniet e punës të tij ndërpriten pasi vendimi i Këshillit bëhet i formës së prerë.

Referuar [Raportit Vjetor](#) të lartëpërmendur, KLGJ ka filluar procesin e verifikimit paraprak të të gjithë kancelarëve në detyrë (37 kancelarë), përfshirë ato të Gjykatave të Krimeve të Rënda (8 kancelarë nga gjykatat e Apeleve, 23 kancelarë nga Gjykatat e rretheve gjyqësore, 6 kancelarë nga Gjykatat e Shkallëve të Para Administrative).

Duhet theksuar fakti, që përmbushja e suksesshme e hapave të lartëpërmendur përbën një proces mjaft thelbësor për fillimin e ushtrimit të aktivitetit të Gjykatave të Posaçme dhe realizimit të objektivave në drejtim të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ashtu siç tregojnë edhe përvoja të ngjashme nga vendet e rajonit, realizimi dhe sigurimi i aspekteve logjistike, administrative, financiare dhe njerëzore kushtëzohet veprimtarinë efiçente të këtyre institucioneve.

- *Koordinimi dhe bashkëpunimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor me Këshillin e Lartë të Prokurorisë me qëllim ngritjen e Gjykatave të Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar duke emëruar me prioritet gjyqtarët, të cilët konfirmohen në detyrë nga organet e vetting-ut*

Megjithëse KLGJ dhe KLP kanë filluar ushtrimin e kompetencave respektive në drejtim të emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të posaçëm, rëndësia e harmonizimit të hapave lidhur me ngritjen e dy organeve kryesore të gjykimit dhe hetimit të veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar mbetet një faktor thelbësor për të siguruar funksionimin efiçent të këtyre strukturave. Gjithashtu, [krijimi i Gjykatës së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar duhet të ndodhë në të njëjtën kohë](#)

[me krijimin e Prokurorisë së Posaçme](#) në mënyrë që të sigurohet vijimësia e shqyrtimit të çështjeve si edhe të respektohen të drejtat dhe garancitë e personave për një gjykim të drejtë.

Në këtë kontekst, angazhimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor për një bashkëpunim me Këshillin e Lartë të Prokurorisë për të mundësuar ngritjen e Gjykatave të Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe emërimi me prioritet i gjyqtarëve, të cilët konfirmohen në detyrë nga organet e vettingut, përbën një nga objektivat më të rëndësishëm të vitit 2019 theksuar në [Raportin Vjetor](#) të KLGJ-së.

Ky raport nuk përshkruan në mënyrë të detajuar angazhime specifike apo bashkëpunime konkrete të planifikuara ndërmjet KLGJ-së dhe KLP-së, por pavarësisht kësaj, periudha në vijim do të konkretizojë angazhimin e dy organeve kryesore të menaxhimit të sistemit gjyqësor dhe prokurorisë në drejtim të ngritjes së Gjykatave dhe Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Statusi i procesit të rivlerësimit të Gjyqtarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda kandidatë për në Gjykatat e Posaçme KKKO

Gjyqtarët e Gjykatave të Krimeve të Rënda kandidatë për në Gjykatat e Posaçme KKKO			Statusi & Vendimi i KPK
Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda			
1.	Sandër Simoni	Kryetar/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
2.	Dritan Hallunaj	Gjyqtar/Gjykata e Shkallës së Parë	Konfirmuar (anëtar i KLGJ)
3.	Ardit Mustafaj	Gjyqtar/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
4.	Irena Gjoka	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
5.	Daniela Shirka	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
6.	Etleva Deda	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
7.	Luan Hasneziri	Gjyqtar/Gjykata e Shkallës së Parë	Konfirmuar
8.	Flora Hajredinaj	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
9.	Fran Prendi	Gjyqtar/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
10.	Ilirjana Olldashi	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
11.	Liljana Baku	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
12.	Marsela Balili	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
13.	Bib Ndreca	Gjyqtar/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
14.	Miliana Muça	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
15.	Klodian Kurushi	Gjyqtar/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
Gjykata e Apelit për Krime të Rënda			
1.	Fehmi Petku	Kryetar/Gjykata e Apelit	Shkarkuar
2.	Gjovalin Pernoca	Gjyqtar/Gjykata e Apelit	Në proces rivlerësimi
3.	Nertina Kosova	Gjyqtare/Gjykata e Apelit	Konfirmuar/APELUAR në KPA
4.	Dhurata Haveri	Gjyqtare/Gjykata e Apelit	Në proces rivlerësimi
5.	Nure Dreni	Gjyqtare/Gjykata e Apelit	Në proces rivlerësimi
6.	Saida Dollani	Gjyqtare/Gjykata e Apelit	Në proces rivlerësimi
7.	Dhimitër Lara	Gjyqtar/Gjykata e Apelit	Konfirmuar
8.	Sokol Binaj	Gjyqtar/Gjykata e Apelit	Konfirmuar
9.	Gurali Brahimllari	Gjyqtar/Gjykata e Apelit	Në proces rivlerësimi
10.	Idriz Mulkurti	Gjyqtar/Gjykata e Apelit	Në proces rivlerësimi
11.	Albana Boksi	Gjyqtare/Gjykata e Apelit	Konfirmuar

* Statusi i rivlerësimit është përditësuar për herë të fundit në datën 13 Qershor 2019